



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 53 datë 06.07.2016

**Për**

**“DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 59, DATË 30.12.2015, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E TIRANËS”, I NDRYSHUAR.**

Në mbështetje nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.3, shkronja “b”, nenit 34, pika 6, nenit 35, pika 4 dhe nenit 54, shkronja “f” të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”; nenit 5, shkronja “a” të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.59, datë 30.12.2015, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” (i ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë ndryshimet në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.59, datë 30.12.2015 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” (i ndryshuar), si vijon:

*Në Pikën II.e “Tarifa e Institucioneve të tjera”, shtohet pika II.e.6 “Tarifa për Muzeun pranë Kullës së Sahatit”, si më poshtë:*

**“Hyrja në Muze: 200 lekë / personi**

*Përfshihen nga aplikimi i kësaj tarife grupet e organizuara të nxënësve të shkollave, pensionistët, veteranët, invalidët e punës e luftës, përfituesit e ndihmës ekonomike, të verbërit, të sëmurët tetraplegjik dhe paraplegjikë, si dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuara sipas përkufizimit të ligjit 93/2014 datë 24.07.2014.”.*

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**